




Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORTI VJETOR 2025 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 05/L - 021 PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Prishtinë, më 3 shtator 2026

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....	4
PARATHËNIE.....	5
I. KORNIZA LIGJORE PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	7
Kushtetuta e Republikës së Kosovës	7
Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi	8
Procedurat ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi sipas LMD-së	9
II. MEKANIZMAT INSTITUCIONALE PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI.....	11
Avokati i Popullit	11
Zyra për Qeverisje të Mirë.....	11
Mekanizmat institucionalë për mbrojtje nga diskriminimi në ministri dhe komuna	11
III. ROLI I INSTITUCIONEVE TË TJERA.....	12
Agjencia për Barazi Gjinore	12
Zyra e Komisionerit për Gjuhët	12
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil	13
Inspektorati i Punës	13
Inspektorati i Tregut.....	13
Inspektorati i Arsimit	14
Inspektorati Shëndetësor.....	14
Komisioni i Pavarur për Media	14
IV. TË GJETURAT E AVOKATIT TË POPULLIT LIDHUR ME RASTET E DISKRIMINIMIT.....	14
AKTET NORMATIVE QË BIEN NDESH ME PARIMIN E MOSDISKRIMINIMIT	15
PRAKTIKAT E PËRGJITHSHME TË CILAT BIEN NDESH ME PARIMIN E MOSDISKRIMINIMIT	15
Diskriminimi mbi bazën e aftësisë së kufizuar	16
Diskriminimi mbi bazën e moshës	18
Diskriminimi në punë	18
Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike	20
Liria e Besimit, e Ndërgjegjës dhe e Fesë.....	21
BARAZIA GJINORE	22
Barazia gjinore në punësim.....	22
Barazia gjinore në pronë dhe trashëgimi.....	22
Mbrojtja nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore.....	23

Viktimat e mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës	23
Të drejtat e personave LGBTIQ+	23
KONKLuzion.....	24
V. TË GJETURAT E AVOKATIT TË POPULLIT NË ROLIN MBIKËQYRËS NË ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI	24
MINISTRITË	26
KOMUNAT	28
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS	31
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS	31
POLICIA E KOSOVËS	31
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS	32
INSTITUCIONET E PAVARURA	32
KOMISIONI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS.....	32
AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS	33
KONKLuzion.....	33
VI. REKOMANDIMET	34

LISTA E SHKURTESAVE

ABGj – Agjencia për Barazi Gjinore
ANJF – Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
AP – Avokati i Popullit
BE – Bashkimi Evropian
FSK – Forca e Sigurisë së Kosovës
GjEDNj – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GjK – Gjykata Kushtetuese
KEDNj – Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
KGjK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KiE – Këshilli i Evropës
KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPM – Komisioni i Pavarur i Mediave
KPMShCK – Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
LBGj – Ligji për Barazi Gjinore
LMD – Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi
MASH – Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MBPZhR – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MDAP – Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike
MD – Ministria e Drejtësisë
ME – Ministria e Ekonomisë
MF – Ministria e Financave
MINTI – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit
MIT – Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
MKK – Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKT – Ministria e Kulturës dhe Turizmit
MAPL – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MM – Ministria e Mbrojtjes
MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB – Ministria e Punëve të Brendshme
MPFVLÇ – Ministria e Punës, Familjes dhe Vlerave të Luftës Çlirimtare
MPJD – Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MSR – Ministria e Sportit dhe Rinisë
MSh – Ministria e Shëndetësisë
MZhR – Ministria e Zhvillimit Rajonal

PARATHËNIE

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kam kënaqësinë t'ia përcjell Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ta publikoj Raportin Vjetor për Zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2025, i cili pasqyron gjendjen e mbrojtjes nga diskriminimi në Republikën e Kosovës, sfidat në zbatimin e legjislacionit përkatës, si dhe gjetjet e Avokatit të Popullit gjatë ushtrimit të mandatit të tij kushtetues dhe ligjor.

Ky është viti i tretë radhazi që Avokati i Popullit i paraqet Kuvendit një raport të veçantë për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Megjithatë, mbetet shqetësues fakti se dy raportet paraprake nuk janë shqyrtuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, për shkak të rrethanave dhe ngërçeve politike që kanë karakterizuar funksionimin institucional gjatë kësaj periudhe.

Mosshqyrtimi i këtyre raporteve ka penguar zhvillimin e debatit institucional dhe parlamentar mbi një nga çështjet më të rëndësishme që lidhen me respektimin e të drejtave të njeriut dhe zbatimin e parimit të barazisë. Po ashtu, kjo ka kufizuar mundësinë që rekomandimet e Avokatit të Popullit të trajtohen në mënyrë sistematike dhe të shndërrohen në politika publike dhe masa konkrete për përmirësimin e mbrojtjes nga diskriminimi.

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se Republika e Kosovës vazhdon të ketë një kornizë ligjore të konsoliduar në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, e harmonizuar në masë të konsiderueshme me standardet evropiane dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Megjithatë, sfida kryesore mbetet zbatimi efektiv dhe i qëndrueshëm i kësaj kornize ligjore në praktikë.

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit ka evidentuar raste të diskriminimit dhe trajtimit të pabarabartë në fusha të ndryshme, përfshirë qasjen në shërbime publike, punësimin, mbrojtjen sociale, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e komuniteteve joshumicë, të drejtat gjuhësore, barazinë gjinore dhe liritë fetare. Në një numër rastesh janë identifikuar praktika administrative dhe dispozita normative që prodhojnë efekte diskriminuese ose krijojnë pengesa të pajustificuara për ushtrimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me ligj.

Raporti evidenton se diskriminimi në Kosovë mbetet një çështje shqetësuese, pasi një numër i konsiderueshëm i rasteve të trajtuara lidhen me mangësi të vazhdueshme në legjislacion, politikat publike, praktikat administrative dhe mekanizmat institucionalë. Gjetjet tregojnë se grupet e cenueshme, veçanërisht personat me aftësi të kufizuara, komunitetet joshumicë, gratë dhe grupet e tjera të marginalizuara, përballen me pengesa të përsëritura në ushtrimin e të drejtave të tyre, pavarësisht garancive kushtetuese dhe ligjore. Në një numër rastesh, këto pengesa lidhen jo vetëm me veprime individuale, por edhe me mënyrën e zbatimit të legjislacionit, politikat dhe praktikat institucionale.

Një shqetësim i veçantë mbetet niveli i ulët i zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nga institucionet publike. Të dhënat e paraqitura në këtë raport tregojnë se një numër i konsiderueshëm institucionesh ende nuk kanë krijuar mekanizma funksionalë për trajtimin e

rasteve të diskriminimit, nuk mbajnë evidenca të plota statistikore dhe nuk u përgjigjen në mënyrë adekuate kërkesave për llogaridhënie dhe monitorim.

Prandaj, ky raport duhet të shërbejë jo vetëm si një pasqyrë e gjendjes aktuale, por edhe si një thirrje për veprim. Respektimi i parimit të barazisë dhe mbrojtja efektive nga diskriminimi nuk janë vetëm obligime ligjore dhe kushtetuese, por përbëjnë themelin e një shoqërie demokratike, gjithëpërfshirëse dhe të drejtë.

Shpreh besimin se Kuvendi i Republikës së Kosovës do ta shqyrtojë këtë raport me seriozitetin që meriton dhe do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar zbatimin e rekomandimeve të paraqitura, në funksion të forcimit të sundimit të ligjit dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët, pa dallim.

I. KORNIZA LIGJORE PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Nisur nga mandati i tij kushtetues për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Avokati i Popullit ka një rol qendror në promovimin e barazisë dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Në cilësinë e organit të barazisë, ai është përgjegjës për promovimin, monitorimin dhe mbështetjen e zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, përmes trajtimit të ankesave, zhvillimit të hetimeve ex officio, pjesëmarrjes si *amicus curiae* në procedura gjyqësore, dhënies së rekomandimeve dhe realizimit të aktiviteteve vetëdijesuese dhe edukative.

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD), Avokati i Popullit mbikëqyr zbatimin e këtij ligji dhe i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës të paktën një herë në vit. Raporti për vitin 2025 përbën raportin e tretë vjetor të përgatitur në përputhje me këtë bazë ligjore.

Republika e Kosovës ka një kornizë të avancuar kushtetuese dhe ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi, e harmonizuar në masë të konsiderueshme me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe legjislacioni sektorial garantojnë ndalimin e diskriminimit si në sektorin public, ashtu edhe në atë privat.

Megjithatë, ndonëse Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi obligon të gjitha autoritetet publike dhe subjektet private të respektojnë parimin e trajtimit të barabartë, kompetencat e Avokatit të Popullit në raport me sektorin privat mbeten të kufizuara. Si rrjedhojë, Avokati i Popullit nuk gëzon kompetenca të plota hetimore dhe mbikëqyrëse për trajtimin e drejtpërdrejtë të rasteve të diskriminimit që ndodhin në sektorin privat. Për këtë arsye, mandati i tij në këtë fushë ushtrohet kryesisht në mënyrë të tërthortë, përmes referimit dhe adresimit të rasteve tek autoritetet administrative, inspektuese dhe kundërvajtëse që kanë kompetenca ligjore për hetimin dhe trajtimin e shkeljeve të tilla në sektorin privat.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës i jep së drejtës për barazi para ligjit dhe mbrojtjes nga diskriminimi status të dyfishtë. Së pari, e drejta për barazi para ligjit dhe ndalimi i diskriminimit sanksionohet si parim themelor kushtetues në Kapitullin I të Kushtetutës [Dispozitat Themelore], konkretisht nenet 3 dhe 7. Së dyti, barazia para ligjit dhe mbrojtja nga diskriminimi garantohej si e drejtë individuale kushtetuese në Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore], përkatësisht në nenin 24.

Përveç kësaj, mbrojtja nga diskriminimi mbështetet edhe në nenin 22 të Kushtetutës [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], i cili parasheh se disa nga këto instrumente ndërkombëtare, që janë pjesë përbërëse e rendit juridik të Kosovës, përmbajnë dispozita që ndalojnë diskriminimin.

Po ashtu, neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës obligon gjykatat dhe të gjitha autoritetet publike të Kosovës që të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, përfshirë

të drejtën për barazi para ligjit dhe mbrojtjen nga diskriminimi, t'i interpretojnë në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ).

Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD) përbën *lex specialis* në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe, si i tillë, zë një vend qendror në trajtimin e çështjeve që lidhen me diskriminimin. Përveç Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ky ligj përbën aktin kryesor normativ mbi bazën e të cilit trajtohen dhe adresohen rastet e diskriminimit në procedurat administrative, gjyqësore, si dhe në procedurat që zhvillohen pranë Avokatit të Popullit. Mbrojtja juridike e garantuar me këtë ligj plotësohet edhe nga dispozita të veçanta të legjislacionit sektorial, të cilat rregullojnë fusha të ndryshme, si arsimi, shëndetësia, punësimi dhe administrata publike.

Ky ligj vendos një kornizë të përgjithshme normative për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të diskriminimit, duke garantuar njëkohësisht të drejtën për barazi para ligjit për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që ndodhen nën juridiksionin e Republikës së Kosovës.

LMD ofron garanci gjithëpërfshirëse kundër diskriminimit, duke paraparë një listë të gjerë dhe jo shteruese të bazave të mbrojtura. Në këtë drejtim, neni 1, paragrafi 1 i ligjit përcakton se qëllimi i tij është parandalimi dhe luftimi i diskriminimit mbi baza të tilla si: kombësia ose lidhja me ndonjë komunitet, prejardhja shoqërore ose kombëtare, raca, etnia, ngjyra, lindja, prejardhja, seksi, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual, gjuha, shtetësia, besimi fetar dhe besimi, përkatësia politike, mendimi politik ose mendimet e tjera, gjendja sociale ose personale, mosha, gjendja familjare ose martesore, shtatzënia, lehonja, gjendja pasurore, gjendja shëndetësore, aftësia e kufizuar, trashëgimia gjenetike ose çdo bazë tjetër.

Ky ligj zbatohet në sektorin publik dhe privat, si dhe përmban përkufizime shumë gjithëpërfshirëse të formave të ndryshme të diskriminimit, duke përfshirë diskriminimin e drejtpërdrejtë, diskriminimin e tërthortë, ngacmimin, nxitjen për të diskriminuar, viktimizimin, segregacionin, diskriminimin në bazë të asociimit, mosdhënien e një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar, diskriminimin në bazë të perceptimit, diskriminimin e shumëfishtë.

Ligji përcakton në mënyrë të qartë përgjegjësinë institucionale për zbatimin e tij, në nivel qendror dhe lokal, ku rol dhe prerogativa të veçanta i janë besuar Avokatit të Popullit. Ligji përmban procedura të veçanta për zbatimin e tij, të përmbledhura në Kreun II, të cilat përcaktojnë mënyrat e mbrojtjes nga diskriminimi në praktikë.

Që nga viti 2024, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD) është në proces të plotësimit dhe ndryshimit. Avokati i Popullit ka marrë pjesë, në cilësinë e vëzhguesit, në grupin punues për hartimin e ndryshimeve të këtij ligji.

Së fundi, Avokati i Popullit ka pranuar informata nga Këshilli i Evropës se versioni i fundit i projektligjit, i cili ka dalë nga takimi i fundit i grupit punues, është analizuar nga Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI). Sipas këtyre informatave, në këtë version të projektligjit janë përfshirë standardet e përcaktuara në Direktivën (BE) 2024/1499¹ të Këshillit të Bashkimit Evropian, të datës 7 maj 2024, për standardet për organet e barazisë në fushën e

¹ https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=OJ:L_202401499

trajtimin të barabartë të personave pavarësisht prejardhjes së tyre racore ose etnike, trajtimin të barabartë në çështjet e punësimit dhe profesionit të personave pavarësisht fesë ose besimit të tyre, aftësisë së kufizuar, moshës ose orientimit seksual, trajtimin të barabartë ndërmjet grave dhe burrave në çështjet e sigurimeve shoqërore dhe në qasjen në dhe furnizimin me mallra dhe shërbime, e cila ndryshon Direktivën 2000/43/EC dhe Direktivën 2004/113/EC.

Po ashtu, në projektligj është përfshirë edhe Direktiva (BE) 2024/1500² e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Bashkimit Evropian, e datës 14 maj 2024, *për standardet për organet e barazisë në fushën e trajtimin të barabartë dhe mundësive të barabarta ndërmjet grave dhe burrave në çështjet e punësimit dhe profesionit*, e cila ndryshon Direktivën 2006/54/EC dhe Direktivën 2010/41/EU.

Gjithashtu, në versionin e fundit të projektligjit është përfshirë edhe Rekomandimi i Politikës së Përgjithshme (GPR) i ECRI-së mbi “Organet e Barazisë për të luftuar racizmin dhe intolerancën në nivel kombëtar”.

Vlen të theksohet se Direktiva 2000/43/EC dhe Direktiva 2004/113/EC, të cilat ndryshohen me Direktivën (BE) 2024/1499, si dhe Direktiva 2006/54/EC, e cila ndryshohet me Direktivën (BE) 2024/1500, janë të inkuorporuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi në Republikën e Kosovës.

Të dyja direktivat kanë hyrë në fuqi më 18 qershor 2024, ndërsa afati për transpozimin e tyre nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian përfundon më 19 qershor 2026. Ky afat përcakton periudhën brenda së cilës Shtetet Anëtare duhet të miratojnë dhe të vënë në fuqi ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë e legjislacionit të tyre me këto direktiva.

Direktivat e Bashkimit Evropian, si rregull i përgjithshëm, u drejtohen Shteteve Anëtare të BE-së. Prandaj, në kuptimin strikt të së drejtës së Bashkimit Evropian, detyrimi për transpozimin e tyre zbatohet për Shtetet Anëtare dhe nuk krijon, në mënyrë të drejtpërdrejtë, detyrim juridik për Kosovën, e cila nuk është shtet anëtar i BE-së.

Megjithatë, kjo nuk nënkupton se standardet e përcaktuara në këto direktiva janë të parëndësishme për procesin e integritimit evropian të Kosovës. Çështja e detyrimeve të Kosovës në këtë drejtim duhet të vlerësohet në kuadër të angazhimeve të saj për përafrimin e legjislacionit me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe të procesit të integritimit evropian. Këto angazhime burojnë, ndër të tjera, nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA/SAA).³

Procedurat ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi sipas LMD-së

LMD-ja ofron mbrojtje të shumëfishtë për personat që pretendojnë se janë diskriminuar. Kjo mund të realizohet përmes procedurave administrative, kundërvajtëse ose gjyqësore. Nëpërmjet këtyre mjeteve, personat e dëmtuar mund të kërkojnë mbrojtje, sanksionimin e shkelësve dhe

² https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=OJ:L_202401500

³ LIGJI Nr. 05/L -069 PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË STABILIZIM ASOCIIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS, NË NJËRËN ANË, DHE BASHKIMIT EVROPIAN DHE KOMUNITETIT EVROPIAN TË ENERGJISË ATOMIKE, NË ANËN TJETËR <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11239>, Neni 74

kompensimin e dëmit. Në përgjithësi, ligji synon të sigurojë mbrojtje efektive gjyqësore dhe administrative kundër çdo forme diskriminimi në sektorin publik dhe privat.

Procedura civile pranë gjykatës

Personi i diskriminuar mund të paraqesë padi në gjykatën kompetente për konstatimin e diskriminimit, ndalimin e veprimeve diskriminuese, eliminimin e pasojave të diskriminimit dhe kompensimin e dëmit material dhe jomaterial.

Padia duhet të parashtrohet brenda afatit ligjor, zakonisht deri në pesë (5) vjet nga momenti kur pala ka marrë dijeni për diskriminimin. Barra e provës lehtësohet për viktimën, pasi, pas paraqitjes së fakteve fillestare, pala tjetër duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim.

Procedura administrative

Të gjitha institucionet, qoftë në nivel lokal apo qendror, janë të detyruara të zbatojnë legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi. Sa herë që pretendohet se ka pasur trajtim diskriminues, hapi i parë mund të jetë paraqitja e një ankese administrative brenda institucionit që pretendohet se ka shkaktuar shkeljen ose që ka përgjegjësi për mënjanimin e saj, si në nivel lokal (komunë), ashtu edhe në nivel qendror (të gjitha institucionet qendrore, duke përfshirë edhe agjencitë e pavarura).

Në rastet kur diskriminimi lidhet me veprime ose vendime të institucioneve publike apo administrative, mund të inicohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente. Kjo bëhet për të kundërshtuar një vendim, mosveprim ose praktikë diskriminuese të organit publik.

Procedura kundërvajtëse

Ligji parasheh mundësinë e shqiptimit të gjobave dhe masave ndaj personave fizikë ose juridikë që kryejnë diskriminim. Këto procedura mund të inicohen nga organet kompetente, në pajtim me ligjin, dhe kanë karakter ndëshkues administrativ (siç janë inspektoratet e ndryshme). Ligji e autorizon Avokatin e Popullit që t'u kërkojë organeve kompetente fillimin e procedurave kundërvajtëse për diskriminim.

Procedura penale

Nëse diskriminimi përmban elemente të veprës penale, mund të inicohet edhe procedurë penale sipas Kodit Penal të Kosovës, përmes ngritjes së kallëzimit penal, nëse diskriminimi përbën veprën penale të “shkeljes së statusit të barabartë të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës,” apo në ndërlidhje me veprën penale të nxitjes së përçarjes, urrejtjes dhe mosdurimit.

Ankesat kundër diskriminimit të dorëzuara te Avokati i Popullit

Para ose paralelisht me gjykatën, pala mund t'i drejtohet edhe institucionit të Avokatit të Popullit, i cili ka kompetencë t'i hetojë rastet e diskriminimit dhe të japë rekomandime për institucionet publike.

Përveç këtyre procedurave tipike juridike, të cilat janë paraqitur më lart, duhet theksuar se neni 21 i LMD-së parasheh se rastet e diskriminimit mund të trajtohen edhe me ndërmjetësim apo pajtim, siç parashihet me legjislacionin në fuqi.

II. MEKANIZMAT INSTITUCIONALË PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI

Zbatimi i LMD-së ka për qëllim të garantojë jetësimin në praktikë të së drejtës kushtetuese të personave për mbrojtje nga diskriminimi në të gjitha fushat e jetës, ndërsa mbikëqyrja është një aktivitet institucional në funksion të garantimit të zbatimit të duhur të ligjit.

LMD-ja parashikon mekanizma institucionalë për mbikëqyrjen e zbatimit të tij dhe i veshë me përgjegjësi të drejtpërdrejtë një numër të kufizuar institucionesh dhe zyrtarësh, për sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të tij.

Avokati i Popullit

Sipas nenit 132, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të autoriteteve publike. Mandati i tij përcaktohet më tej në Ligjin për Avokatin e Popullit, Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD) dhe Ligjin për Barazinë Gjinore (LBGj).

Kompetencat e Avokatit të Popullit në zbatimin e LMD-së janë të parashikuara në nenet 9, 12 dhe 18 të ligjit. Sipas nenit 9, paragrafi 2, pika 2.1, Avokati i Popullit pranon, heton dhe ndërmjetëson në parashitjet për diskriminim, si dhe jep mendime dhe rekomandime. Neni 9, paragrafi 2, pika 2.6 e obligon atë ta përcjellë zbatimin e LMD-së dhe të nxisë ndryshimet e nevojshme ligjore. Ndërsa pika 2.12 përcakton se Avokati i Popullit çdo vit i raporton Kuvendit për zbatimin e ligjit.

Rolet plotësuese të Avokatit të Popullit në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi përcaktohen në nenin 12 dhe nenin 18 të LMD-së.

Zyra për Qeverisje të Mirë

Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM), e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ka rol qendror dhe koordinues në zbatimin e LMD-së nga ana e Qeverisë. Ajo këshillon Qeverinë në çështjet e barazisë, siguron që politikat dhe projektligjet të jenë në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut dhe monitoron zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. ZQM-ja harton politika dhe plane veprimi, mbledh të dhëna dhe kryen studime për grupet e ndjeshme, si dhe çdo vit i raporton Qeverisë për zbatimin e LMD-së.

Si mekanizëm koordinues, ZQM-ja udhëheq procesin e bashkëpunimit me ministritë dhe komunat, të cilat janë të obliguara të caktojnë zyrtarë për zbatimin e LMD-së. Ajo gjithashtu propozon aktet nënligjore që përcaktojnë mënyrën e raportimit dhe koordinimit institucional. Përveç kësaj, ZQM-ja bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare dhe mbështet Qeverinë në krijimin e partneriteteve me organizata joqeveritare për avancimin e barazisë dhe luftimin e diskriminimit.

Mekanizmat institucionalë për mbrojtje nga diskriminimi në ministri dhe komuna

Rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e zbatimit të LMD-së kanë edhe njësitë dhe zyrtarët për mbrojtjen nga diskriminimi në ministri dhe komuna.

LMD-ja, neni 11, përcakton se të gjitha ministritë dhe komunat janë të obliguara të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës. Ky mekanizëm institucional shtrin mbrojtjen nga diskriminimi në nivel qendror dhe lokal, përgjatë tërë strukturës institucionale shtetërore. Bazuar në Rregulloren nr.

03/2017 për Mekanizmat Institucional për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Qeveri dhe Komuna, në nenin 5, paragrafi 2, përcaktohet se njësia apo zyrtari përkatës për mbrojtjen nga diskriminimi, në kuadër të ministrive dhe komunave, janë përgjegjës për bashkëpunim, koordinim, monitorim, raportim, mbrojtje dhe promovim të barazisë dhe mundësive të barabarta, si dhe për koordinimin e Strategjisë për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe instrumentet ndërkombëtare që zbatohen në Republikën e Kosovës.

III. ROLI I INSTITUCIONEVE TË TJERA

Agjencia për Barazi Gjinore

Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore (LBGj) është pjesë e pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut në Kosovë, pako kjo e cila përfshin Ligjin për Avokatin e Popullit dhe Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ky ligj përcakton funksionin dhe rolin e Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGj), e cila është një agjenci ekzekutive që vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Ky ligj është i ndërlidhur ngushtë me LMD-në, i cili përcakton kuadrin e përgjithshëm për mbrojtjen e çdo individi nga çdo formë diskriminimi, pavarësisht bazës mbi të cilën ndodh – qoftë gjinia, identiteti gjinor apo orientimi seksual. Ndërsa LMD-ja ka karakter të përgjithshëm dhe mbulon të gjitha format e diskriminimit, LBGj-ja fokusohet në barazinë gjinore si komponent themelor i të drejtave të njeriut, duke forcuar mekanizmat institucionale për zbatimin praktik të saj.

Në përputhje me nenin 8 të LBGj-së, ABGj-ja ka një sërë funksionesh dhe përgjegjësisë që synojnë promovimin dhe përforcimin e parimeve të barazisë gjinore. Ajo mbështet zbatimin e LBGj-së duke propozuar ndryshime ligjore, masa afirmative dhe politika të nevojshme për parandalimin e diskriminimit me bazë gjinore. ABGj-ja monitoron gjendjen e barazisë gjinore në institucionet publike, harton raporte analitike dhe ofron rekomandime. Po ashtu, agjencia bashkëpunon ngushtë me institucionet qeveritare dhe shoqërinë civile për të siguruar integrimin e perspektivës gjinore dhe për t'i avancuar të drejtat e grave dhe vajzave.

Zyra e Komisionerit për Gjuhët

Zyra e Komisionerit për Gjuhët, e themeluar në bazë të Ligjit Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, ka mandat të mbikëqyrë dhe të sigurojë zbatimin e këtij ligji në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Roli i saj është të garantojë ruajtjen, promovimin dhe mbrojtjen e gjuhëve zyrtare, si dhe të gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare. Të gjitha institucionet publike janë të obliguara të bashkëpunojnë me Zyrën dhe t'i dorëzojnë informacionet dhe raportet e nevojshme, ndërsa në secilin institucion caktohet një person kontaktues për çështjet e gjuhëve.

Zyra ka kompetencë të kryejë hetime me iniciativë të vet ose mbi bazën e ankesave nga persona fizikë apo juridikë, në rastet kur dyshohet për moszbatimin e ligjit apo të akteve të tjera që rregullojnë përdorimin e gjuhëve. Ajo mund të ndërmarrë masa brenda kompetencave të saj, përfshirë ndërmjetësimin, me qëllim që institucionet të veprojnë në përputhje me ligjin. Përveç funksionit mbikëqyrës, ZKGj-ja mbështet Qeverinë në zbatimin e programeve të informimit publik, duke kontribuar që qytetarët të jenë të mirëinformuar për të drejtat e tyre gjuhësore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është organ i pavarur që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, sipas Kushtetutës dhe Ligjit përkatës për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli luan një rol të rëndësishëm në funksion të vendosjes së drejtësisë administrative për mbrojtjen e të drejtave të zyrtarëve publikë nga trajtimet e padrejta, përfshirë diskriminimin në marrëdhëniet e punës.

Po ashtu, është e rëndësishme të theksohet se Këshilli mbikëqyr zbatimin e dispozitave ligjore, duke përfshirë edhe respektimin e kuotave të punësimit për grupet e nënpërfaqësura në institucionet publike, të cilat mund të zbatojnë masa afirmative, sipas legjislacionit përkatës për mbrojtjen nga diskriminimi.

Inspektorati i Punës

Inspektorati i Punës ka kompetencë për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të Ligjit të Punës, të cilat e rregullojnë marrëdhënien e punës, sigurinë dhe mbrojtjen në punë.

Sipas nenit 5 të Ligjit të Punës, diskriminimi ndalohet në mënyrë të rreptë në të gjitha aspektet e marrëdhënies së punës, duke përfshirë rekrutimin, trajnimin, avancimin, kushtet e punës, masat disiplinore dhe ndërprerjen e kontratës së punës. Kjo dispozitë garanton mbrojtje nga çdo formë e diskriminimit, qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, veçanërisht ndaj personave me aftësi të kufizuara, për sa kohë që ata janë në gjendje t'i kryejnë detyrat e punës në mënyrë të adekuate.

Në këtë kuadër, Inspektorati i Punës ka kompetenca të qarta për të monitoruar, hetuar dhe ndërmarrë masa ndaj çdo shkeljeje që lidhet me diskriminimin në vendin e punës. Inspektorët e punës janë të autorizuar të kryejnë inspektime të rregullta ose të jashtëzakonshme në institucionet publike dhe në sektorin privat, me qëllim të verifikimit të zbatimit të parimeve të barazisë dhe të trajtimit të drejtë në marrëdhëniet e punës.

Kur gjatë inspektimeve konstatohet se një punëdhënës ka vepruar në mënyrë diskriminuese, në fazën e konkursit, punësimit, trajtimit të punëtorëve apo ndërprerjes së kontratës, Inspektorati ka të drejtë të urdhërojë ndalimin e menjëhershëm të praktikave diskriminuese, të kërkojë korrigjimin e situatës dhe rivendosjen e trajtimit të barabartë, si dhe të propozojë masa ndëshkuese apo administrative sipas ligjit në fuqi.

Gjithashtu, Inspektorati i Punës ka rol parandalues dhe edukues, duke ofruar këshilla, trajnime dhe udhëzime për punëdhënësit dhe punëmarrësit lidhur me ndalimin e diskriminimit dhe zbatimin e standardeve të barazisë gjinore dhe profesionale.

Inspektorati i Tregut

Inspektorati i Tregut siguron që konsumatorët të mos diskriminohen në qasje dhe në marrjen e shërbimeve apo mallrave. Ai mbron konsumatorët nga praktikat diskriminuese dhe mbikëqyr ofruesit e shërbimeve për të garantuar trajtim të barabartë. Përmes monitorimit të standardeve në treg, Inspektorati i Tregut kontribuon në parandalimin e diskriminimit ekonomik dhe social në shërbimet publike e private. Gjithashtu, është e rëndësishme që, te shërbimet publike që i ofrohen konsumatorit, ofruesi i cili ofron shërbim publik përmes rrjetit të shpërndarjes duhet t'i lejojë konsumatorit qasje në rrjetin e shpërndarjes dhe të ofrojë shërbime në përputhje me rregulloret e

veçanta, kontratat e koncesionit ose aktet e tjera të qeverisjes lokale në territorin e së cilës ofrohet shërbimi, me kushte jodiskriminuese.

Inspektorati i Arsimit

Inspektorati i Arsimit mbikëqyr respektimin e parimit të mosdiskriminimit në institucionet arsimore, duke trajtuar ankesat e nxënësve, prindërve, studentëve dhe stafit arsimor. Ai siguron qasje të barabartë në arsim, monitoron proceset e punësimit në arsim dhe ndërhyr kur vërehen praktika diskriminuese. Përmes këtij roli, Inspektorati i Arsimit promovon një sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë.

Inspektorati Shëndetësor

Inspektorati Shëndetësor garanton që institucionet shëndetësore ofrojnë shërbime pa diskriminim, si për pacientët, ashtu edhe për stafin shëndetësor. Ai heton shkeljet, jep rekomandime profesionale dhe ndërmerr masa për trajtim të barabartë në qasjen dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Kontributi i tij është esencial për funksionimin e një sistemi shëndetësor gjithëpërfshirës dhe jodiskriminues.

Komisioni i Pavarur për Media

Komisioni i Pavarur për Media (KPM) është institucion i pavarur kushtetues, i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet, si dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë, të cilët ofrojnë shërbime mediale audio dhe audiovizuale.

KPM-ja monitoron përmbajtjet audio dhe audiovizuale për të parandaluar shpërndarjen e materialeve që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhës nxitëse, fyese ose nënçmuese, ndërmerr masa ndaj shkeljeve dhe siguron që operatorët medialë t'i respektojnë standardet ligjore dhe etike të mosdiskriminimit.

IV. TË GJETURAT E AVOKATIT TË POPULLIT LIDHUR ME RASTET E DISKRIMINIMIT

Sipas LMD-së, Avokati i Popullit pranon, heton dhe ndërmjetëson në parashtresat për diskriminim, si dhe jep mendime dhe rekomandime. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit ofron një pasqyrë të rasteve të hetuara nga institucioni, në të cilat është konstatuar se ka pasur diskriminim.

Numri i përgjithshëm i ankesave të evidentuara në Departamentin për Mbrojtje nga Diskriminimi të Avokatit të Popullit është 106, prej të cilave 26 raste kanë të bëjnë me pretendime për diskriminim, ndërsa 4 raste janë hapur sipas detyrës zyrtare (ex officio).

Bazat e pretenduara në rastet e hetuara të diskriminimit janë: aftësia e kufizuar, mosha, përkatësia etnike, statusi social, gjinia, orientimi seksual, gjendja shëndetësore, përkatësia politike dhe baza të tjera të mbrojtura me nenin 1 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Nga 16 raporte me rekomandime të publikuara, bazuar në ankesat e pranuar ose të hapura sipas detyrës zyrtare, 7 prej tyre kanë të bëjnë me konstatime për shkelje të të drejtave të njeriut, trajtim të pabarabartë dhe diskriminim.

Gjithashtu, Avokati i Popullit ka publikuar katër opinione për autoritetet publike dhe dy opinione *amicus curiae*, në cilësinë e mikut të gjykatës.

AKTET NORMATIVE QË BIEN NDESH ME PARIMIN E MOSDISKRIMINIMIT

Parimi i barazisë është një nga parimet themelore mbi të cilat mbështetet legjislacioni vendor. Si parim juridik që përshkon çdo segment të sferës shoqërore, parimi i barazisë përfaqëson një shtyllë themelore të sistemeve bashkëkohore juridike dhe një kërkesë që u vihet çdo shteti për të rritur vazhdimisht standardet e respektimit të të drejtave të njeriut. Gjatë trajtimit të ankesave individuale apo edhe rasteve ex officio, Avokati i Popullit has në dispozita të akteve normative që bien ndesh me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka identifikuar dy raste kur aktet normative përmbajnë dispozita që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë ndikim në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti

Avokati i Popullit trajtoi çështjen e njohjes të së drejtës për përfitim të pensioneve mbi dy baza të ndryshme ligjore. Rasti lidhej me moszbatimin e një aktgjykimi që ua njihte qytetarëve të drejtën për pension kontributpagues dhe pension mbi një bazë tjetër ligjore. Megjithëse tanimë ekziston praktikë gjyqësore në favor të qytetarëve, autoritetet vazhduan të refuzojnë kërkesat për pensione të dyfishta.

Avokati i Popullit konstatoi se trajtimi i ndryshëm i rasteve të ngjashme cenon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, krijon pasiguri juridike dhe detyron qytetarët të ndjekin procedura gjyqësore për realizimin e të drejtave të tyre. Gjithashtu, u vlerësua se mungon një qasje institucionale për harmonizimin e politikave pensionale me standardet kushtetuese dhe gjyqësore. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Qeveria nuk kanë ndërmarrë nismë për ndonjë analizë apo plan konkret për zgjidhjen e kësaj problematike, pavarësisht ekzistencës së shumë skemave dhe ligjeve pensionale në Kosovë, të cilat shpesh nuk janë të harmonizuara ndërmjet vete.

Rregullorja e Brendshme nr. 11/2024 për Pranimin e Drejtorit të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Avokati i Popullit shqyrtoi dy ankesa lidhur me konkursin për drejtor të Sekretariatit të KQZ-së, të shpallur sipas Rregullores së Brendshme nr. 11/2024 për Pozitën e Drejtorit të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ku kërkohej dëshmi e njohjes së gjuhës angleze në nivelin B2, ekskluzivisht përmes certifikatave TOEFL ose IELTS. Dispozita përkatëse u shfuqizua nga vetë KQZ-ja para përfundimit të hetimeve nga Avokati i Popullit.

Megjithatë, Avokati i Popullit konstatoi se kufizimi i dëshmimit të njohjes së gjuhës vetëm përmes dy certifikatave specifike ishte joproporcional dhe cenonte parimin e trajtimit të barabartë. Kriteri u vlerësua si diskriminues dhe pa mbështetje të mjaftueshme ligjore.

PRAKTIKAT E PËRGJITHSHME TË CILAT BIEN NDESH ME PARIMIN E MOSDISKRIMINIMIT

Megjithëse ekziston një konsensus se korniza ligjore në Republikën e Kosovës është e avancuar në kuptimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe fushës së mosdiskriminimit, Avokati i Popullit,

gjatë hetimit të rasteve, has në situata kur ligjet zbatohen në mënyrë të gabuar apo nuk zbatohen fare, praktika këto që bien ndesh me parimin e mosdiskriminimit dhe të trajtimit të barabartë.

Diskriminimi mbi bazën e aftësisë së kufizuar

Personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me vështirësi në qasjen në shërbime shëndetësore, arsim, punësim dhe pjesëmarrje në jetën publike.

Avokati i Popullit, në vazhdimësi, përmes rekomandimeve drejtuar autoriteteve shtetërore, ka adresuar çështje lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Disa prej rekomandimeve, si ai për rivlerësimin mjekësor të aftësisë së kufizuar për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, kanë çuar në ndryshimin e rregullativës që ishte në kundërshtim me Ligjin nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në vitin 2023, njëzëri ka vendosur që listës së marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare drejtpërdrejt të aplikueshme në Republikën e Kosovës t'i shtohet edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara përcakton respektin për dinjitetin e natyrshëm, autonominë individuale, përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale dhe pavarësinë e personit me aftësi të kufizuara; respektimin e parimit të mosdiskriminimit; pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri; respektin për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit; respektin për kapacitetet në zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara; si dhe respektin për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara për të ruajtur identitetin e tyre.

Me miratimin e kësaj Konvente, Republika e Kosovës do të merrte përsipër detyrime specifike pozitive, ndër të tjera, për ndërmarrjen e masave të nevojshme legislative, si dhe masave të tjera, duke krijuar mekanizma në funksion të zbatimit të plotë të Konventës në fjalë. Pavarësisht vendimit të Gjykatës Kushtetuese, kjo Konventë ende nuk është miratuar nga Kuvendi.

Mosofrimi i trajtimit të përshtatshëm shëndetësor stomatologjik dhe diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar

Rasti kishte të bënte me një qytetare me aftësi të kufizuara dhe me gjendje të rënduar shëndetësore, e cila nuk kishte marrë trajtimin e nevojshëm stomatologjik në QKSUK dhe ishte detyruar të kërkonte trajtim jashtë vendit. Hetimi evidentoi mungesë të procedurave të përshtatura dhe të kapaciteteve profesionale për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara dhe gjendje të rënduar shëndetësore⁴.

Avokati i Popullit konstatoi diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore, pasi ankueses nuk iu garantua qasje e barabartë në shërbime shëndetësore. U theksua

⁴ <https://oik-rks.org/2025/01/13/raport-i-avokatit-te-popullit-r-nr-649-2024-ne-lidhje-me-detyrimet-e-organeve-shteterore-per-te-vepruar-ne-perputhje-me-parimet-e-ligjit-per-mbrojtje-nga-diskriminimi-dhe-me-legjislacionin-ne-fuqi-p/>

gjithashtu ekzistenca e një problemi më të gjerë sistematik që prek persona të tjerë me aftësi të kufizuara.

Avokati i Popullit ka rekomanduar që Ministria e Shëndetësisë të nxjerrë udhëzime të posaçme për institucionet shëndetësore publike për përshtatjen e procedurave diagnostikuese dhe trajtuese sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuara dhe të krijojë mekanizma për kompensimin e shpenzimeve për trajtime stomatologjike që nuk ofrohen në vend; Inspektorati Shëndetësor të monitorojë zbatimin e standardeve ligjore dhe profesionale, ndërsa QKSUK-ja të zbatojë në mënyrë të plotë Udhërrëfyesin Klinik nr. 28 në rastet e diagnostikimit dhe trajtimit të këtyre kategorive të pacientëve.

Reduktimi i tarifave të energjisë elektrike për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe për personat e verbër

Avokati i Popullit shqyrtoi zbatimin e programit qeveritar për konsumatorët e cenueshëm të energjisë elektrike, i cili kushtëzonte përfitimin me nivelin e të ardhurave familjare. Ky program ndikonte edhe te personat paraplegjikë, personat tetraplegjikë dhe personat e verbër, të cilët gëzojnë të drejta të veçanta sipas ligjeve specifike⁵.

U konstatua se kushtëzimi i përfitimit me të ardhurat familjare anashkalon të drejtat e garantuara me ligjet përkatëse që përcaktojnë reduktime për tarifën e energjisë elektrike për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe për personat e verbër. Avokati i Popullit vlerësoi se përfitimet duhet të bazohen në statusin ligjor të personit dhe jo në gjendjen ekonomike të familjes së tij/saj.

Lidhur me këtë rast, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve i është rekomanduar nxjerrja e një udhëzimi administrativ për kriteret për reduktim në tarifën e konsumit të energjisë elektrike për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, në funksion të zbatimit të Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, si dhe nxjerrja e një udhëzimi administrativ për kriteret për reduktim në tarifën e konsumit të energjisë elektrike për personat e verbër në funksion të zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër.

E drejta e votës për personat të cilëve pjesërisht u është hequr zotësia e veprimit

Rasti kishte të bënte me mohimin e së drejtës së votës për një qytetare me Sindromën Down, së cilës, me një vendim gjyqësor, i ishte hequr pjesërisht zotësia e veprimit⁶.

Avokati i Popullit analizoi praktikën e përjashtimit automatik nga listat e votuesve të personave nën kujdestari. Heqja automatike e të drejtës së votës, sipas listave që Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) ia përcjell KQZ-së me qëllim të përgatitjes së listave të votuesve me të drejtë vote, pa një vlerësim individual, përbën trajtim diskriminues ndaj personave me aftësi të kufizuara. Avokati i Popullit rekomandoi që e drejta e votës të kufizohet vetëm kur kjo përcaktohet shprehimisht me vendim gjyqësor.

Avokati i Popullit është vënë në dijeni se ankuesja, pavarësisht faktit se ndaj saj është marrë vendim për heqjen e zotësisë së veprimit, ka ushtruar të drejtën e votës në zgjedhjet e fundit të

⁵ <https://oik-rks.org/2025/04/14/raport-i-avokatit-te-popullit-r-nr-94-2024-lidhur-me-mohimin-e-te-drejtës-ne-reduktimin-e-tarifave-te-energjisë-elektrike-per-personat-paraplegjik-tetraplegjik-dhe-personat-e-verber/>

⁶ <https://oik-rks.org/2025/12/15/raport-i-avokatit-te-popullit-r-nr-226-2025-lidhur-me-mohimin-e-te-drejtës-se-votës/>

mbajtura më 28 dhjetor 2025. Megjithatë, Avokati i Popullit vlerëson se çështja duhet të trajtohet, duke normuar se në cilat rrethana personave mund t'u kufizohen të drejtat zgjedhore dhe e drejta e pjesëmarrjes.

Diskriminimi mbi bazën e moshës

Avokati i Popullit ka vazhduar të trajtojë çështjet që kanë të bëjnë me diskriminimin mbi bazën e moshës. Nga gjetjet e Avokatit të Popullit rezulton se diskriminimi mbi bazën e moshës shpesh ndërlidhet edhe me baza të tjera të mbrojtura dhe rezulton me diskriminim të shumëfishtë, sepse, përveç diskriminimit për shkak të moshës, diskriminimi ndodh edhe mbi ndonjë nga bazat e tjera të mbrojtura me nenin 1 të LMD-së.

Diskriminimi mbi bazën e moshës në konkursin e shpallur nga Dogana e Kosovës

Avokati i Popullit shqyrtoi konkursin për oficerë doganorë, ku kandidatët kërkohej të ishin nën moshën 30 vjeç. Hetimi tregoi se ky kriter nuk mbështetej në legjislacionin përkatës dhe nuk kishte bazë të qartë ligjore.⁷

U konstatua se kufizimi i qasjes në punësim vetëm mbi bazën e moshës përbën diskriminim të drejtpërdrejtë. Arsyetimet e dhëna nga Dogana nuk u konsideruan të mjaftueshme për të justifikuar trajtimin e ndryshëm të kandidatëve.

Si rrjedhojë, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Doganës së Kosovës heqjen e kriterit të moshës nga aktet përkatëse, si dhe publikimin e rregullt të tyre.

Dogana e Kosovës e ka njoftuar Avokatin e Popullit se është në proces të hartimit të një udhëzimi të ri administrativ, bazuar në Kodin e ri Doganor, duke përfshirë harmonizimin me standardet më të larta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe, në të njëjtën kohë, duke marrë në konsideratë rekomandimet e Avokatit të Popullit.

Diskriminimi në punë

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit ka trajtuar një numër të konsiderueshëm ankesash që lidhen me pretendime për diskriminim në marrëdhëniet e punës. Këto ankesa kanë përfshirë trajtim të pabarabartë në punësim, kushte pune, avancim profesional dhe ndërprerje të marrëdhënies së punës, duke evidentuar nevojën për masa më efektive institucionale për parandalimin dhe adresimin e diskriminimit në punë.

Mendim në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) lidhur me transferim të vendit të punës në KOSTT

Avokati i Popullit i paraqiti Gjykatës Themelore në Prishtinë një mendim juridik lidhur me rastin e një punonjëseje të KOSTT-it, e cila ishte transferuar në një pozitë më të ulët pune. Hetimi tregoi se vendimi për uljen në pozitë nuk ishte mbështetur në procedurë disiplinore, në arsyetim të ligjshëm apo në ndonjë detyrim që rridhte nga një aktgjykim gjyqësor në të cilin ishte mbështetur KOSTT-i.

⁷ <https://oik-rks.org/2025/05/06/raport-i-avokatit-te-popullit-r-nr-231-2024-r-nr-234-2024-dhe-r-nr-244-2024-lidhur-me-bazen-ligjore-per-percaktimin-e-kriterit-te-moshes-per-aplikim-ne-konkurs-ne-doganen-e-kosoves/>

Avokati i Popullit konstatoi se transferimi përbënte degradim të paligjshëm dhe se rikthimi në fuqi i vendimeve të mëparshme administrative, pa e zhvilluar ndonjë procedurë administrative apo gjyqësore, cenonte sigurinë juridike. Gjithashtu, mosshqyrtimi i ankesave të ankueses dhe trajtimi i ndryshëm krahasuar me një punonjës tjetër krijonin dyshim të bazuar për trajtim diskriminues dhe shkelje të parimit të trajtimit të barabartë në marrëdhëniet e punës.

Opinion amicus curiae lidhur me anulimin e konkursit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë

Avokati i Popullit paraqiti mendim juridik lidhur me një rast të mosdhënies së kontratës së punës dhe anulimit të konkursit për pozitën e drejtorit të përgjithshëm në Institutin e Mjekësisë Ligjore. Ankuesja ishte shpallur kandidate e suksesshme, por emërimi i saj u pezullua për shkak të një procedure disiplinore dhe hetimi penal, të cilat më vonë përfunduan pa konstatuar shkelje apo përgjegjësi.

Avokati i Popullit gjeti se anulimi i konkursit dhe moszbatimi i vendimit për përzgjedhjen e ankueses ishin ndërmarrë pa arsyetim të qartë ligjor. U theksua se veprimet e institucioneve duhet të respektojnë parimin e ligjshmërisë, prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për trajtim të drejtë e të paanshëm, pasi vazhdimi i kufizimit të të drejtave të ankueses, pavarësisht mungesës së shkeljeve të konstatuara, mund të rezultojë në trajtim të padrejtë dhe të pabarabartë.

Opinion për Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me të drejtat e të punësuarve tek Operatorët Ekonomikë që ofrojnë shërbime për institucionet publike

Avokati i Popullit ka publikuar një opinion lidhur me të drejtat e punëtorëve të punësuar te operatorët ekonomikë që ofrojnë shërbime për institucionet publike. Avokati i Popullit, në bazë të kompetencave ligjore, hapi rast sipas detyrës zyrtare lidhur me dyshimet për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me Ligjin e Punës ndaj punëtorëve të angazhuara në shërbime të mirëmbajtjes dhe pastrimit në institucione publike. Rasti u hap pas njoftimeve të punëtorëve që kishin hyrë në grevë, të cilat ngritën shqetësime për paga të ulëta, mospagim të punës jashtë orarit dhe gjatë fundjavave, pamundësi për shfrytëzim të pushimit mjekësor, si dhe mospagim të kontributeve pensionale⁸.

Gjatë hetimit u konstatuan shkelje të të drejtave të punës dhe u ngrit shqetësimi për diskriminim strukturor me bazë gjinore, pasi të prekurat ishin kryesisht gra. Avokati i Popullit theksoi përgjegjësinë e institucioneve publike për të siguruar respektimin e të drejtave të punëtorëve nga operatorët ekonomikë.

Opinion i Avokatit të Popullit në lidhje me detyrimet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për të vepruar në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi

Rasti lidhej me eliminimin e një kandidati nga procedura e rekrutimit për shkak të lidhjes familjare me një punonjëse të fakultetit, ndonëse ajo nuk kishte rol në procesin e përzgjedhjes. Ankuesi pretendonte mungesë transparence dhe trajtim të pabarabartë. Avokati i Popullit konstatoi se përjashtimi i kandidatit vetëm për shkak të lidhjes familjare, pa konflikt real interesi, përbënte

⁸ <https://oik-rks.org/2025/05/06/raport-i-avokatit-te-popullit-r-nr-231-2024-r-nr-234-2024-dhe-r-nr-244-2024-lidhur-me-bazen-ligjore-per-percaktimin-e-kriterit-te-moshes-per-aplikim-ne-konkurs-ne-doganen-e-kosoves/>

trajtim të pabarabartë dhe diskriminues. U theksua se qasja në punësim duhet të bazohet në meritë dhe jo në supozime të përgjithshme mbi lidhjet familjare.

Avokati i Popullit është vënë në dijeni se edhe Gjykata Supreme, më 10 dhjetor 2025, ka nxjerrë një aktgjykim lidhur me një rast të ngjashëm, me ç'rast ka shpallur të paligjshëm dhe ka shfuqizuar nenin 153, paragrafët 3 dhe 4, të Statutit të Universitetit të Prishtinës, si dhe nenin 7, paragrafin 6, të Rregullores nr. 2/54 për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës.

Gjykata konstatoi se këto dispozita vendosnin ndalesa absolute pa vlerësim konkret të konfliktit të interesit, duke shkelur parimet kushtetuese të barazisë, meritokracisë dhe ndalimit të diskriminimit. Ajo vlerësoi se masat ishin joproporcionale dhe në kundërshtim me ligjet për arsimin e lartë dhe parandalimin e konfliktit të interesit, pasi përjashtonin kandidatët vetëm për shkak të lidhjeve familjare.

Gjykata theksoi se lidhja familjare nuk përbën automatikisht nepotizëm dhe se dispozitat e kontestuara cenonin të drejtën për konkurrim të barabartë dhe ushtrim të funksioneve akademike sipas meritës.

Opinion i Avokatit të Popullit në lidhje me detyrimet e organeve shtetërore për të vepruar në përputhje me parimet ligjore përkatëse

Avokati i Popullit shqyrtoi ankesën e një zyrtari policor, i cili pretendonte se Prokuroria Themelore në Gjilan dhe Inspektorati Policor i Kosovës kishin cenuar të drejtën e tij për ushtrimin e profesionit në mënyrë të pavarur dhe të drejtë⁹. Ankesa lidhej me veprimet e ndërmarra pas një incidenti në vitin 2023, kur ankuesi urdhëroi ndalimin e një automjeti të drejtuar nga një prokuror për shkelje në trafik, pas së cilës u iniciuan procedura penale dhe masa administrative ndaj tij.

Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike

Avokati i Popullit vlerëson se, pavarësisht arritjeve të shënuara ndër vite, në Kosovë komunitetet joshumicë vazhdojnë të përballen ende me forma të ndryshme të diskriminimit në shërbime publike, në punësim, në arsim dhe në përfaqësimin institucional. Kjo situatë dëshmon se nevojiten përpjekje të vazhdueshme dhe masa më efektive për të garantuar barazi të plotë dhe mbrojtje të të drejtave të tyre.

Raporti me Rekomandime lidhur me dështimin e institucioneve publike për përmbushje të kuotës për punësimin e pjesëtarëve të komunitetit joshumicë

Gjatë shqyrtimit të një ankese kundër KQZ-së lidhur me shkeljet e parimeve të miradministrimit në procedurat e rekrutimit, Avokati i Popullit analizoi edhe përfaqësimin e komuniteteve joshumicë në institucionet publike.

Hetimi evidentoi mungesë të të dhënave të plota dhe përfaqësim të ulët të komuniteteve në administratën publike.

⁹ <https://oik-rks.org/2025/11/04/opinion-i-avokatit-te-popullit-r-nr-176-2024-ne-lidhje-me-detyrimet-e-organeve-shteterore-per-te-vepruar-ne-perputhje-me-parimet-ligjore-perkatese/>

Megjithëse nuk u konstatua diskriminim individual në rastin konkret, gjetjet treguan rrezik për mosrealizimin efektiv të përfaqësimit të drejtë etnik. Avokati i Popullit kërkoi monitorim më të mirë dhe përdorim të masave afirmative për komunitetet e nënpërfaqësuar.

Të drejtat gjuhësore

Avokati i Popullit monitoroi respektimin e të drejtave gjuhësore dhe publikoi raport lidhur me shërbimet e bankave komerciale¹⁰. Hetimi evidentoi mungesë të dokumentacionit dhe shërbimeve në gjuhën serbe, si dhe mungesë të stafit që e flet këtë gjuhë.

U konstatua se këto praktika krijojnë pengesa për qytetarët serbishtfolës dhe përbëjnë trajtim të pabarabartë në qasjen në shërbime. Avokati i Popullit i cilësoi këto raste si diskriminim në bazë të gjuhës dhe kërkoi masa korrigjuese nga BQK-ja.

BQK-ja iu përgjigj rekomandimeve të Avokatit të Popullit se BQK-ja, në përputhje me mandatin e saj ligjor, përmes rolit të saj si rregullator dhe mbikëqyrës i sektorit bankar, do të kontribuojë në mënyrë konstruktive në përmirësimin e situatës në këtë sektor. Në këtë kuptim, do t'u lëshohet një letër këshilluese bankave komerciale, në të cilën do të paraqiten gjetjet e raportit të Avokatit të Popullit dhe, siç pritet nga rregullatori, do të kërkohet respektimi i përdorimit të gjuhëve zyrtare në Kosovë, me qëllim promovimin e praktikave të mira dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore, duke përfshirë dispozitat e Ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare.

Pezullimi i pagesës së shtesës për fëmijë

Avokati i Popullit hapi hetim ex officio pas një numri të madh ankesash lidhur me pezullimin e shtesave për fëmijë, kryesisht nga familje të komunitetit serb¹¹. Pagesat u pezulluan gjatë një procesi verifikimi pa vendime individuale dhe pa informim të qartë për qytetarët.

Sipas gjetjeve, procedurat e aplikuara krijuan efekte disproporcionale ndaj komuniteteve joshumicë, veçanërisht ndaj komunitetit serb. Avokati i Popullit vlerësoi se veprimet e institucioneve cenonin sigurinë juridike dhe prodhonin pasoja diskriminuese për fëmijët e këtyre komuniteteve.

Avokati i Popullit ka rekomanduar publikimin e menjëhershëm dhe transparent të të gjitha akteve dhe udhëzimeve për verifikim, sigurimin e procedurave të qarta dhe të qasshme për qytetarët, nxjerrjen e vendimeve individuale të arsyetuara dhe realizimin e pagesave retroaktive për të gjithë përfituesit, përfshirë edhe periudhën e pezullimit dhe përfitimet shtesë të parapara.

Liria e Besimit, e Ndërgjegjës dhe e Fesë

Liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë në Kosovë garantohet me nenin 38 të Kushtetutës dhe nenin 9 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Fusha rregullohet nga Ligji nr. 02/L-31 për Liritë Fetare, i cili mbetet në fuqi, por nuk rregullon në mënyrë të plotë statusin juridik të bashkësive fetare, përfshirë regjistrimin, personalitetin juridik dhe çështjet pronësore e financiare.

¹⁰ <https://oik-rks.org/2026/01/15/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-152-2023-ne-lidhje-me-perdorimin-e-gjuheve-zyrtare-ne-bankat-komerciale-ne-kosove/>

¹¹ <https://oik-rks.org/2025/05/29/leter-rekomandim-ex-officio-nr-68-2025/>

Kjo krijon boshllëqe ligjore dhe vështirësi praktike në ushtrimin e lirive fetare. Iniciativa për ndryshimin e ligjit, vite me radhë, ka mbetur e papërfunduar, gjë që vazhdon të ndikojë negativisht në realizimin e plotë të lirive fetare, veçanërisht për bashkësitë më të vogla.

Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit trajtoi katër raste që lidhen me të drejtat dhe liritë fetare, përfshirë statusin juridik të bashkësive fetare, qasjen në objekte fetare, ushtrimin e lirive fetare në institucione arsimore dhe pretendime për diskriminim mbi bazë fetare. Një rast kishte të bënte me kushtetutshmërinë e disa dispozitave të Ligjit për Liritë Fetare dhe trajtimin e bashkësive më të vogla. Një rast tjetër lidhej me qasjen fizike në një xhami në Kamenicë, ku përmes ndërmjetësimit u arrit zgjidhje pa konstatuar shkelje të të drejtave të njeriut.

Çështja e mbajtjes së shamisë në institucione arsimore mbeti aktuale. Pas një ndërhyrjeje të Avokatit të Popullit lidhur me përjashtimin e dy nxënësve nga mësimi, atyre iu mundësua vazhdimi i mësimi.

Megjithëse nuk janë paraqitur ankesa të tjera formale, rastet e trajtuara tregojnë ekzistencën e problemeve sistematike dhe nevojën për reforma ligjore. Avokati i Popullit vlerëson të domosdoshëm miratimin e një ligji të ri për liritë fetare, forcimin e monitorimit të rasteve të diskriminimit fetar dhe qartësimin e normave që rregullojnë ushtrimin e lirive fetare në institucione arsimore.

Ndërsa, sipas Policisë së Kosovës, gjatë vitit 2025 janë raportuar 35 raste të veprave penale kundër trashëgimisë kulturore dhe fetare.

BARAZIA GJINORE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e përcakton barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë dhe garanton mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në të gjitha fushat e jetës. Ligji për Barazi Gjinore e përcakton Avokatin e Popullit si institucion të barazisë, me mandat për trajtimin e rasteve të diskriminimit gjinor.

Barazia gjinore në punësim

Avokati i Popullit rikujton se Raporti ex officio nr. 535/2019¹² i Avokatit të Popullit evidentoi përfaqësim të pabarabartë gjinor në nivelet drejtuese dhe administrative të institucioneve publike. Deri në realizimin e një vlerësimi të ri, Avokati i Popullit konsideron se gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në sektorin publik.

Diskriminimi gjinor në vendin e punës vazhdon të paraqitet edhe në formën e ngacmimit seksual. Gjatë vitit 2025, Avokati i Popullit ka trajtuar një rast me pretendime për ngacmim seksual, për të hetuar nëse punëdhënësi ka mekanizma adekuatë për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të tilla.

Barazia gjinore në pronë dhe trashëgimi

Sipas të dhënave të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, në vitin 2023, 19.79% e pronave ishin të regjistruara në emër të grave. Në vitin 2024, kjo përqindje u rrit në 20.23%, ndërsa në vitin 2025

¹² <https://oik-rks.org/2024/12/16/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-535-2019-ne-lidhje-me-zbatimin-e-masave-te-vecanta-te-parapara-me-nenin-6-masat-e-vecanta-te-ligjit-nr-05-l-020-per-barazi-gjinore-nga-ana-e-organeve-legj/>

kjo përqindje arriti në 21.02%. Megjithëse vërehet një trend pozitiv dhe rritje graduale e pronësisë së regjistruar në emër të grave, ritmi i kësaj rritjeje mbetet ende i ulët dhe relativisht i ngadalshëm.

Avokati i Popullit vlerëson se pengesat kryesore për realizimin e të drejtave pronësore dhe trashëgimore të grave lidhen me normat tradicionale, mungesën e informimit, heqjen dorë nga trashëgimia për arsye familjare dhe zvarritjet procedurale në rastet e kontesteve pronësore. Gjatë vitit raportues është trajtuar një rast këshillimi juridik për ndarjen e trashëgimisë, ku ankuesja u informua për të drejtat e saj ligjore dhe mundësinë e ndihmës juridike falas.

Mbrojtja nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-185 dhe zbatimin e mekanizmave të mbikëqyrjes elektronike, Kosova ka avancuar në mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore. Megjithatë, këto forma të dhunës vazhdojnë të jenë të përhapura, veçanërisht dhuna psikologjike, seksuale dhe ekonomike.

Sipas Policisë së Kosovës, gjatë vitit 2025 janë raportuar 2.509 raste të dhunës në familje, krahasuar me 2.547 raste në vitin 2024. Ndërkaq, rastet e raportuara të ngacmimit seksual kanë rënë nga 102 në vitin 2024 në 64 raste në vitin 2025¹³.

Viktimat e mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës

Gjatë vitit 2025 nuk janë paraqitur ankesa nga viktimat e mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës. Megjithatë, Avokati i Popullit rikujton raportin e vitit 2024, i cili identifikoi mangësi ligjore dhe procedurale në procesin e njohjes së statusit të viktimave, përfshirë mungesën e afateve të qarta, paqartësi procedurale, vonesa në pajisjen me kartela identifikuese dhe mungesë të mbështetjes psiko-sociale.

Avokati i Popullit ka rekomanduar përmirësimin e kornizës ligjore dhe institucionale për të garantuar trajtim dinjitoz, konfidencialitet dhe qasje efektive në të drejtat e garantuara për viktimat.

Të drejtat e personave LGBTIQ+

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka trajtuar një ankesë lidhur me gjuhën e përdorur ndaj komunitetit LGBTIQ+ gjatë fushatës zgjedhore. Duke pasur parasysh trajtimin paraprak të çështjes nga institucionet kompetente dhe dokumentet e publikuara nga Avokati i Popullit mbi diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes, rasti është mbyllur.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka vazhduar hetimin e një rasti të hapur në vitin 2024, të paraqitur nga “Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore” (CSGD), në emër të personit N.N. (me kod mbrojtës të viktimës të caktuar me vendim gjykate “Fabian”). Rasti kishte të bënte me kërkesën për monitorimin e seancave gjyqësore lidhur me lëndën PKR. nr. 112/2024. Nga gjithsej gjashtë (6) seanca të mbajtura, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë monitoruar pesë (5) prej tyre. Avokati i Popullit vlerëson se procesi gjyqësor është zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe në pajtim me ligjin.

¹³ Nga një përgjigje nga Policia e Kosovës, e datës 21 maj 2026, thuhet se gjatë vitit 2025, PK-ja ka pranuar 183 raportime për ngacmim seksual, prej të cilave 60 i janë referuar Prokurorisë.

Në seancën e datës 13 janar 2025 u shpall aktgjykimi në këtë rast, me të cilin të akuzuarit u shpallën fajtor për veprat penale për të cilat ishin akuzuar.

Sipas Policisë së Kosovës, gjatë vitit 2025 janë raportuar tri raste të veprave penale ndaj pjesëtarëve të komunitetit LGBTIQ+.

KONKLuzion

Gjendja e diskriminimit në Kosovë vazhdon të mbetet shqetësuese, pavarësisht ekzistencës së një kornize ligjore të avancuar për mbrojtjen nga diskriminimi. Avokati i Popullit vlerëson se problemet kryesore nuk lidhen me mungesën e ligjeve, por me zbatimin e tyre të pamjaftueshëm, interpretimet e gabuara dhe praktikat administrative që prodhojnë trajtim të pabarabartë. Gjatë periudhës raportuese janë evidentuar raste diskriminimi në fusha të ndryshme, përfshirë aftësinë e kufizuar, moshën, përkatësinë etnike, gjininë, gjuhën, punësimin dhe qasjen në shërbime publike.

Veçanërisht të cenueshëm mbeten personat me aftësi të kufizuara, komunitetet joshumicë, gratë dhe grupet e tjera të marginalizuara, që vazhdojnë të përballen me pengesa në realizimin e të drejtave të tyre.

V. TË GJETURAT E AVOKATIT TË POPULLIT NË ROLIN MBIKËQYRËS NË ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Avokati i Popullit, në Raportin për zbatimin e LMD-së për vitin 2024, ka rekomanduar që institucionet përgjegjëse të hartojnë plane veprimi për zbatimin e rekomandimeve të tij në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi. Gjithashtu, është rekomanduar që gjatë procesit të ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të qartësohen mekanizmat, kompetencat dhe përgjegjësitë për zbatimin efektiv të tij.

Ndër rekomandimet kryesore përfshihen edhe funksionalizimi i njësive ose emërimi i zyrtarëve për mbrojtje nga diskriminimi në të gjitha institucionet që për këtë obligohen me ligj, standardizimi i detyrave dhe përgjegjësi të tyre, si dhe mbajtja e evidencës së rasteve të diskriminimit. Po ashtu, Avokati i Popullit ka rekomanduar qartësimin e rolit të Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM), organizimin e trajnimeve për zyrtarët përgjegjës dhe krijimin e sistemeve të veçanta për regjistrimin dhe monitorimin e rasteve të diskriminimit nga gjykatat dhe prokuroritë.

Për më tepër, është rekomanduar që institucionet publike të publikojnë në mënyrë të qartë procedurat për paraqitjen e ankesave te Avokati i Popullit, si dhe të zhvillojnë aktivitete të vazhdueshme për promovimin e barazisë dhe rritjen e vetëdijes kundër diskriminimit.

Megjithatë, nga të dhënat e grumbulluara dhe informacionet e pranuar, veçanërisht nga Zyra për Qeverisje të Mirë, rezulton se zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe i rekomandimeve të Avokatit të Popullit mbetet në nivel jashtëzakonisht të ulët.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të ligjit, Avokati i Popullit u ka dërguar kërkesa për informacione 38 komunave dhe 19 ministrive, të cilat, sipas LMD-së, kanë obligim të caktojnë njësi ose zyrtarë përgjegjës për koordinimin, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të ligjit. Kërkesa për informacione i është dërguar edhe Zyrës për Qeverisje të Mirë, në cilësinë e mekanizmit koordinues, raportues dhe bashkëpunues me mekanizmat institucionalë për mbrojtje nga diskriminimi.

Gjithashtu, kërkesa për informacione u janë dërguar edhe 14 institucioneve, autoriteteve dhe organeve të tjera, përfshirë Gjykatën Kushtetuese, Komisionin e Pavarur për Media, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Komisionarin Parlamentar të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Policinë e Kosovës, Inspektoratin Policor të Kosovës, Inspektoratin e Punës, Inspektoratin Shëndetësor, Inspektoratin e Arsimit, Zyrën e Komisionerit për Gjuhët dhe Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas. Nga këto institucione, vetëm nëntë i janë përgjigjur kërkesës së Avokatit të Popullit¹⁴.

Në përgjithësi, nga 71 institucione, autoritete dhe organe publike, të cilave Avokati i Popullit u ka kërkuar informacione lidhur me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vetëm 27 prej tyre kanë ofruar përgjigje. Kjo shkallë e ulët e përgjigjes reflekton mungesë të angazhimit institucional dhe paraqet një tregues shqetësues për nivelin e zbatimit dhe monitorimit të këtij ligji.

ZYRA PËR QEVERISJE TË MIRË

Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) ka ofruar informata lidhur me përgjegjësitë që i burojnë nga LMD-ja. Për sa i përket rolit të saj koordinues dhe monitorues në zbatimin e këtij ligji, ZQM-ja ka njoftuar se nuk ekziston një praktikë e unifikuar lidhur me caktimin e zyrtarëve për mbrojtje nga diskriminimi në komuna. Në këtë drejtim, disa komuna kanë caktuar disa zyrtarë për mbrojtje nga diskriminimi, disa vetëm një zyrtar, ndërsa ka edhe komuna që ende nuk kanë caktuar asnjë zyrtar.

Sipas ZQM-së, shumica e institucioneve publike tashmë kanë caktuar zyrtarë ose njësi përgjegjëse për mbrojtje nga diskriminimi. Të dhënat e ZQM-së tregojnë se 75.8% e institucioneve janë përgjigjur se kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërsa 15.2% kanë deklaruar se ende nuk e kanë bërë një caktim të tillë.

Megjithatë, sipas ZQM-së, edhe në rastet kur janë caktuar zyrtarët apo njësitë për mbrojtje nga diskriminimi, funksionimi i tyre vazhdon të përballet me pengesa dhe vështirësi, kryesisht për shkak të mungesës së përshkrimit të qartë të detyrave dhe përgjegjësi. Sipas vlerësimit të ZQM-së, kjo situatë ka qenë e njëjtë edhe gjatë vitit 2024, ndërsa gjatë vitit 2025 nuk është shënuar ndonjë përmirësim substancial. Një gjendje e tillë rrezikon që zyrtarët për mbrojtje nga diskriminimi të mbeten të emëruar vetëm formalisht, pa ushtruar në mënyrë efektive funksionet e tyre.

Po ashtu, ZQM-ja ka njoftuar se vetëm në 21.9% të institucioneve zyrtarët për mbrojtje nga diskriminimi ose zyrtarët për të drejtat e njeriut janë caktuar me detyrë primare zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërsa në shumicën e institucioneve të tjera këto përgjegjësi u janë ngarkuar si detyra shtesë përmes vendimeve të veçanta.

Pavarësisht se shumica e institucioneve kanë caktuar zyrtarë për mbrojtje nga diskriminimi, mungesa e detyrave të qarta dhe caktimi i tyre si përgjegjësi shtesë vazhdon ta kufizojë efektivitetin e mekanizmave institucionalë për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

¹⁴ Komisioni i Pavarur për Media (KPM), Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Policia e Kosovës (PK), Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM), Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ) dhe Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF).

Një informatë shumë e rëndësishme nga ZQM-ja ka të bëjë me zbatueshmërinë e rekomandimeve të Avokatit të Popullit për vitin 2025, brenda të cilit Avokati i Popullit i ka adresuar 645 rekomandime, prej të cilave 78 janë të adresuara për autoritetet qeveritare. Sipas ZQM-së, nga 78 rekomandime për autoritetet qeveritare vetëm 11 rekomandime apo 14.01% konsiderohen si të zbatuara. Gjendja, sipas ZQM-së, ka qenë e njëjtë edhe në dy-tri vitet e paraprake.

ZYRA E KOMISIONERIT PËR GJUHËT

Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGj), në përputhje me Ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve dhe aktet nënligjore përkatëse, e ushtron mandatin e saj përmes monitorimit të zbatimit të të drejtave gjuhësore, trajtimit të ankesave, monitorimit institucional dhe komunikimit me institucionet publike.

ZKGj-ja ka njoftuar se gjatë vitit 2025 ka pranuar 11 ankesa, prej të cilave nëntë janë trajtuar dhe zgjidhur. Po ashtu, kjo zyrë ka nxjerrë 18 rekomandime drejtuar institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, me qëllim të përmirësimit të respektimit dhe zbatimit të të drejtave gjuhësore.

MINISTRITË

Nga 19 ministri të cilave Avokati i Popullit u ka kërkuar informacione lidhur me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përgjigje kanë kthyer vetëm 6 ministri: Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Ministria e Sportit dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, si dhe Ministria e Drejtësisë.

Ministria e Ekonomisë

Ministria e Ekonomisë ka njoftuar se në kuadër të saj është emëruar zyrtari përgjegjës për mbrojtjen nga diskriminimi, me mandat për monitorimin e zbatimit të masave për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, ofrimin e këshillave dhe udhëzimeve lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin, si dhe për hartimin e raporteve periodike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa u përket rasteve me pretendime për diskriminim gjatë vitit 2025, ministria ka njoftuar se nuk ka pranuar dhe as nuk ka trajtuar asnjë rast të tillë.

Ministria e Financave

Ministria e Financave ka njoftuar se ka ndërmarrë masa për zbatimin e obligimeve që rrjedhin nga Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke përfshirë caktimin e zyrtarit përgjegjës për koordinimin dhe raportimin e çështjeve që lidhen me zbatimin e këtij ligji në kuadër të ministrisë. Ministria ka bërë të ditur se zyrtarët janë informuar për mundësinë e paraqitjes së ankesave te zyrtari përgjegjës, përmes Manualit për Zbatimin e Politikës kundër Ngacmimit Seksual nga Organet e Administratës Publike në Republikën e Kosovës. Po ashtu, ministria ka njoftuar se gjatë vitit 2025 nuk ka pranuar dhe se nuk janë raportuar raste me pretendime për diskriminim.

Ministria e Sportit dhe Rinisë

Ministria e Sportit dhe Rinisë ka njoftuar se ndërmerr veprime dhe masa konkrete për promovimin e një mjedisi gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë qytetarët. Sipas përgjigjes së ministrisë, janë zbatuar politika dhe praktika institucionale që synojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe parandalimin e diskriminimit. Gjithashtu, ministria është angazhuar në ngritjen e kapaciteteve

profesionale të stafit lidhur me zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe në sigurimin e trajtimit të drejtë dhe të paanshëm të palëve në procedurat administrative dhe institucionale. Ministria nuk ka ofruar të dhëna lidhur me numrin e ankesave të pranuara dhe të trajtuara me pretendime për diskriminim, por ka theksuar se çdo ankesë apo kërkesë trajtohet në përputhje me procedurat ligjore dhe administrative në fuqi, duke garantuar transparencë, paanshmëri dhe respektim të standardeve të të drejtave të njeriut.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka njoftuar se ka caktuar zyrtarin përgjegjës për koordinimin dhe raportimin, si dhe ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga LMD-ja. Ministria ka ndërmarrë gjithashtu masa për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi. Është përgatitur plani i veprimit për zbatimin dhe evidentimin e rekomandimeve, ndërsa, pas vlerësimit ex-post të ligjit, pritet rishikimi i strukturës për të drejtat e njeriut dhe mosdiskriminim, përfshirë përcaktimin e qartë të përgjegjësive të zyrtarit kundër diskriminimit. Gjithashtu, në faqen zyrtare të Ministrisë është publikuar informacioni për procedurat e ankimimit të Avokati i Popullit lidhur me çështjet e diskriminimit.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka njoftuar se ka zhvilluar aktivitete të vazhdueshme për sensibilizimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si dhe masa mbështetëse për kategoritë e ndjeshme. Gjatë viteve 2024–2026 janë ndarë bursa për vajzat studente në fushat STEM, për studentët me aftësi të kufizuara dhe për ata të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Po ashtu, janë mbështetur qendrat mësimore për këto komunitete, janë ndarë bursa për nxënësit e shkollave të mesme dhe janë ndërmarrë masa për parandalimin e braktisjes së shkollimit dhe krijimin e mundësive të barabarta.

Për sa u përket rasteve të diskriminimit, Ministria sqaron se gjatë vitit 2025 nuk është evidentuar asnjë ankesë që përmbante pretendime për diskriminim, qoftë nga zyrat përgjegjëse, Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa apo Inspektorati.

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë ka njoftuar se ka caktuar Zyrtarin për të Drejtat e Njeriut si përgjegjës për koordinimin, monitorimin dhe raportimin lidhur me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD).

Ministria ka njoftuar se, gjatë vitit raportues, në nivelin qendror të Ministrisë nuk janë evidentuar raste të regjistruara të diskriminimit. Ndërkaq, përmes sistemit të ndihmës juridike falas janë trajtuar dy raste që përfshinin pretendime për diskriminim, të cilat janë ende në procedurë.

Ministria ka njoftuar gjithashtu se, përmes platformës zyrtare “Ankesa dhe Peticione”, pranon dhe regjistron ankesat e qytetarëve, përfshirë edhe ankesat që lidhen me pretendime për diskriminim.

Po ashtu, Ministria ka bërë të ditur se ka publikuar lidhjen (linkun) për procedurat dhe mënyrën e paraqitjes së ankesave pranë Avokatit të Popullit.

Sipas Ministrisë, janë ndërmarrë masa për evidentimin dhe raportimin e rasteve të diskriminimit, ngritjen e kapaciteteve, sigurimin e qasjes së barabartë në shërbime, akomodimin e personave me aftësi të kufizuara, si dhe mbështetjen e grupeve të cënueshme.

KOMUNAT

Nga 38 komuna përgjigje kanë kthyer 15 komunat si në vijim: Komuna e Rahovecit, Komuna e Junikut, Komuna e Gjakovës, Komuna e Kamenicës, Komuna e Vushtrisë, Komuna e Shtimes, Komuna e Hanit të Elezit, Komuna e Prizrenit, Komuna e Gjilanit, Komuna e Drenasit, Komuna e Lipjanit, Komuna e Fushë Kosovës, Komuna e Ferizajt, Komuna e Shtërpçës dhe Komuna e Zveçanit.

Komuna e Drenasit

Komuna e Drenasit ka njoftuar se planifikon të ndërmarrë veprime konkrete për avancimin e parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit që burojnë nga Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD). Komuna ka raportuar se mban evidencë për rastet që i drejtohen institucionit lidhur me çështje të kësaj natyre dhe se ankesat trajtohen përmes Komisionit të Ankesave.

Sipas të dhënave të komunës, gjatë vitit 2025 janë pranuar gjithsej 28 ankesa me pretendime për diskriminim. Nga këto, 27 ankesa janë refuzuar, ndërsa një ankesë është aprovuar. Ankesat kanë të bëjnë kryesisht me pagesën e orëve shtesë, kompensimin për punë gjatë fundjavës, kujdestaritë dhe pagesat jubilarë, me pretendime për diskriminim për shkak të mënyrës së kalkulimit sipas kategorive përkatëse.

Komuna e Ferizajt

Komuna e Ferizajt ka njoftuar se në këtë komunë funksionon Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komuniteteve, si mekanizëm institucional përgjegjës për evidentimin, trajtimin dhe adresimin e ankesave me pretendime për diskriminim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në këtë drejtim, komuna ka caktuar një zyrtarë për mbrojtje nga diskriminimi, ndërsa vendimi përkatës pritet të formalizohet përmes Kabinetit të Kryetarit dhe Zyrës Ligjore. Komuna ka njoftuar gjithashtu se çështjet përkatëse trajtohen në koordinim me Kabinetin e Kryetarit, në përputhje me rekomandimet dhe komunikimet institucionale, përfshirë ato të adresuara nga Avokati i Popullit.

Megjithatë, komuna ka bërë të ditur se gjatë vitit 2025 nuk është raportuar asnjë rast apo pretendim për diskriminim dhe se nuk ka pasur procedura gjyqësore apo administrative ndaj komunës mbi ndonjë rast në bazat e diskriminimit të përcaktuara në LMD.

Komuna e Fushë Kosovës

Lidhur me kërkesën e Avokatit të Popullit, Komuna e Fushë Kosovës ka nxjerrë një vendim për qasje në dokumente publike, duke theksuar se duhet të respektohen kufizimet ligjore që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionit konfidencial.

Komuna ka njoftuar për veprimet dhe aktivitetet e realizuara me qëllim të promovimit dhe zbatimit të këtij LMD-je. Më tej, në përgjigje thuhet se komuna ka publikuar në faqen zyrtare platformën

për të drejtat e njeriut, ndërsa gjatë vitit 2025 nuk ka pranuar asnjë rast me pretendime për diskriminim.

Komuna e Gjakovës

Komuna e Gjakovës ka njoftuar se ekzistojnë mekanizma institucionalë, ekipe përgjegjëse dhe institucione kompetente për trajtimin e ankesave për diskriminim në pajtim me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, gjatë periudhës raportuese nuk është evidentuar asnjë rast i diskriminimit.

Komuna e Gjilanit

Komuna e Gjilanit ka njoftuar se ka plotësuar pozitën e rregullt të punës për Zyrtar për Mbrojtje nga Diskriminimi. Gjithashtu, është planifikuar që ky zyrtar të trajnohet për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, me qëllim të monitorimit të zbatimit të LMD-së.

Po ashtu, komuna planifikon krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për mbledhjen dhe klasifikimin e të dhënave të ndara sipas bazave dhe formave kryesore të diskriminimit, në përputhje me rekomandimet e Avokatit të Popullit. Sipas komunës, gjatë vitit 2025 nuk është raportuar asnjë rast diskriminimi.

Komuna e Hanit të Elezit

Komuna e Hanit të Elezit ka njoftuar se, me vendim për caktimin e detyrave shtesë, ka emëruar një zyrtarë përgjegjëse për çështjet që lidhen me mbrojtjen nga diskriminimi, në përputhje me obligimet ligjore në fuqi. Komuna nuk ka pranuar asnjë rast me pretendime për diskriminim gjatë vitit 2025.

Komuna e Junikut

Komuna e Junikut ka njoftuar se pranon dhe trajton ankesa të çdo natyre, përfshirë edhe ankesat për diskriminim, përmes kutisë së ankesave, ku qytetarët mund të paraqesin shqetësimet e tyre.

Komuna ka bërë të ditur se, pas rekomandimit të Avokatit të Popullit për vendosjen e lidhjes elektronike (linkut) për ankesa në faqen e Avokatit të Popullit, kjo është integruar në faqen zyrtare të komunës.

Për shkak të mungesës së stafit dhe kufizimeve buxhetore, me vendim është caktuar një zyrtar me detyra shtesë për raportimin lidhur me zbatimin e LMD-së. Komuna mban evidencë për ankesat e pranuar, por deri më tani nuk ka pranuar asnjë ankesë për diskriminim.

Komuna e Kamenicës

Komuna e Kamenicës ka raportuar për aktivitetet e realizuara nga zyrtarja për mbrojtje nga diskriminimi, duke përfshirë publikimin e videospoteve informuese, fushatat dhe ligjëratat vetëdijesuese në shkolla.

Përmes këtyre aktiviteteve, qytetarët kanë pasur mundësi të paraqesin shqetësimet e tyre dhe të marrin informata lidhur me të drejtat e tyre dhe mekanizmat institucionalë për mbrojtje nga diskriminimi. Komuna nuk ka pranuar ankesa për diskriminim, megjithëse qytetarë të ndryshëm kanë kërkuar këshilla dhe informata lidhur me mënyrat e raportimit dhe trajtimit të rasteve të diskriminimit.

Komuna e Lipjanit

Komuna e Lipjanit ka njoftuar se ka të vendosur mekanizmin përkatës për raportimin e rasteve të diskriminimit. Në këtë kuadër, me vendim të kryetarit të Komunës, është emëruar zyrtarja përgjegjëse për mbrojtjen nga diskriminimi.

Institucioni mban regjistër të ankesave që kanë të bëjnë me pretendime për diskriminim, por gjatë vitit 2025 nuk është paraqitur asnjë rast i tillë.

Komuna e Prizrenit

Komuna e Prizrenit ka kthyer përgjigje përmes e-mailit, duke kërkuar nga Avokati i Popullit që ta kontaktojë drejtpërdrejt zyrtarin përgjegjës, ndonëse shkresa e Avokatit të Popullit i ishte adresuar kryetarit të Komunës.

Nga përmbajtja e përgjigjes së pranuar rezulton se zyrtarët përkatës të Komunës së Prizrenit nuk e kanë kuptuar siç duhet rolin dhe mandatin kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit, si dhe as natyrën e komunikimit institucional me këtë institucion.

Kërkesa e Avokatit të Popullit iu drejtua kryetarit të Komunës dhe, për rrjedhojë, ajo duhej të trajtohej me prioritetin dhe përgjegjësinë e duhur institucionale, si dhe në përputhje me rregullat e komunikimit zyrtar dhe parimet e bashkëpunimit ndërinstitutional.

Një qasje e tillë është e rëndësishme për të siguruar bashkëpunim efektiv me Avokatin e Popullit dhe për të mundësuar ushtrimin e plotë dhe të papenguar të mandatit të tij në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Komuna e Rahovecit

Komuna e Rahovecit ka njoftuar se që nga viti 2020 ka caktuar një zyrtare, së cilës me vendim i janë deleguar detyra shtesë si Zyrtare për Mbrojtje nga Diskriminimi. Komuna nuk ka raportuar ndonjë ankesë për diskriminim gjatë vitit 2025.

Komuna e Shtimes

Komuna e Shtimes ka njoftuar se ka planifikuar dhe realizuar aktivitete me qëllim të zvogëlimit të diskriminimit mbi çfarëdo baze dhe rritjes së nivelit të respektimit të të drejtave të njeriut, në kontekstin e barazisë ndërmjet qytetarëve dhe gjinive.

Sipas komunës, deri më tani nuk janë paraqitur ankesa me pretendime për diskriminim.

Komuna e Shtërpces

Komuna e Shtërpces ka njoftuar se prej vitesh nuk janë organizuar aktivitete, takime apo iniciativa të veçanta lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi. Gjithashtu, është bërë e ditur se nuk është pranuar asnjë ankesë për diskriminim.

Komuna e Vushtrisë

Komuna e Vushtrisë ka njoftuar se nuk ka pranuar asnjë ankesë që bazohet në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Gjithashtu, komuna ka bërë të ditur se nuk ka pranuar rekomandime nga Avokati i Popullit.

Megjithatë, komuna nuk ka ofruar informata nëse ka caktuar zyrtar për mbrojtje nga diskriminimi.

Komuna e Zveçanit

Komuna e Zveçanit ka njoftuar se gjatë periudhës raportuese nuk është paraqitur asnjë rast i diskriminimit.

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) ka njoftuar se Zyra për Statistika, në kuadër të KGjK-së, pas verifikimit të të dhënave në Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), ka identifikuar raste gjyqësore të regjistruara dhe të trajtuara nga gjykatat themelore në Republikën e Kosovës, të cilat ndërlidhen me pretendime për diskriminim, përkatësisht me çështje nga marrëdhëniet e punës dhe ndalimin e diskriminimit. Sipas përgjigjes së KGjK-së, gjatë vitit 2025 janë evidentuar tri raste që përfshijnë çështje civile dhe konteste pune të ndërlidhura me pretendime për diskriminim. Megjithatë, KGjK-ja nuk ka ofruar informata lidhur me bazat e pretenduara të diskriminimit në këto raste.

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka njoftuar për të dhënat statistikore të pranuar nga prokuroritë në mbarë vendin, duke ofruar një pasqyrë të rasteve që ndërlidhen me veprat penale: “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës”, “Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit”, veprat penale të motivuara nga urrejtja dhe “Ngacmimi seksual”.

Për sa i përket veprës penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës”, KPK-ja ka njoftuar se në nivel vendi janë pranuar 10 kallëzime penale. Prej tyre, katër raste janë hedhur poshtë, ndërsa nuk është raportuar për asnjë aktgjykim dënues.

Lidhur me veprën penale “Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit”, janë raportuar gjithsej 57 raste të pranuar ose të trashëguara. Nga këto, në 10 raste janë nxjerrë aktgjykime dënuese, ndërsa për pesë raste është raportuar se janë zgjidhur, pa ofruar informata lidhur me mënyrën apo rezultatin e zgjidhjes së tyre.

Asnjë nga prokuroritë nuk ka raportuar raste që ndërlidhen me vepra penale të motivuara nga urrejtja.

Lidhur me veprën penale “Ngacmimi seksual”, KPK-ja ka njoftuar se janë pranuar ose trashëguar 137 raste, ndërsa për 25 prej tyre janë nxjerrë aktgjykime dënuese.

POLICIA E KOSOVËS

Policia e Kosovës ka ofruar të dhëna lidhur me numrin e rasteve të raportuara që ndërlidhen me veprat penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës”, “Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit”, veprat penale të motivuara nga urrejtja dhe “Ngacmimi seksual”.

Për sa u përket veprave penale të motivuara nga urrejtja, Policia e Kosovës nuk ka raportuar asnjë rast gjatë periudhës raportuese.

Lidhur me veprën penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës”, Policia e Kosovës ka raportuar një rast, për të cilin është njoftuar se është mbyllur në mënyrë të veçantë.

Për sa i përket veprës penale “Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit”, janë raportuar 141 raste. Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, një rast është mbyllur në mënyrë të veçantë, tri raste janë hedhur poshtë nga prokurori, një rast është përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë, 12 raste i janë referuar prokurorisë, ndërsa një rast është ende në hetim.

Për veprën penale “Ngacmimi seksual”, Policia e Kosovës ka raportuar 183 raste. Nga këto, dy raste janë mbyllur në mënyrë të veçantë, katër raste janë hedhur poshtë nga prokurori, 60 raste i janë referuar prokurorisë, ndërsa tri raste janë në fazën e hetimeve.

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

Sikurse në vitin e kaluar, vetëm Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ka kthyer përgjigje në kërkesën e Avokatit të Popullit. IPK-ja ka njoftuar se gjatë periudhës raportuese nuk ka iniciuar asnjë rast që ndërlidhet me pretendime për diskriminim mbi ndonjërin nga bazat e përcaktuara në nenin 1, paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

INSTITUCIONET E PAVARURA

Nga institucionet e pavarura, ndaj kërkesës së Avokatit të Popullit ka reaguar vetëm Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), i cili nuk ka ofruar informata lidhur me çështjet substanciale të ngritura në kërkesë, por ka kërkuar korrigjimin e adresimit të saj.

Avokati i Popullit e kishte adresuar kërkesën te kryeshefi ekzekutiv i KPM-së. Megjithatë, sipas përgjigjes së KPM-së, që nga 1 tetori 2024, funksionin e kryeshefit ekzekutiv e ushtron një person tjetër dhe se personi të cilit i ishte adresuar shkresa nuk ka ushtruar asnjëherë funksionin e kryeshefit ekzekutiv.

Avokati i Popullit vlerëson se KPM-ja, sikurse çdo institucion tjetër që ushtron autoritet publik në Republikën e Kosovës, do të duhej ta përcillte kërkesën te zyrtari kompetent dhe përgjegjës, në përputhje me parimet e përcaktuara në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pavarësisht ndonjë pasaktësie eventuale në adresimin e saj.

Kjo vlen veçanërisht për faktin se kërkesa i ishte drejtuar KPM-së si institucion dhe jo një personi fizik në cilësinë e tij personale. Për rrjedhojë, kjo çështje nuk do të duhej të paraqiste pengesë për trajtimin dhe përcjelljen e kërkesës te personi përgjegjës, si dhe për ofrimin e përgjigjes lidhur me çështjet substanciale të ngritura nga Avokati i Popullit.

KOMISIONI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Komisioni i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMShCK) ka njoftuar se gjatë vitit 2025 ka pranuar 2.093 ankesa të rregullta. Sipas informacionit të ofruar, në disa prej këtyre rasteve ankuesit kanë pretenduar se institucionet përkatëse kanë vepruar në mënyrë diskriminuese. KPMShCK-ja ka bërë të ditur se këto pretendime janë trajtuar në frymën e dispozitave të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, veçanërisht nenit 7, paragrafi 1, dhe nenit 8, paragrafi 1, si dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Megjithatë, KPMSHCK-ja nuk ka ofruar të dhëna statistikore lidhur me numrin e ankesave që përmbajnë pretendime për diskriminim, bazat e pretenduara të diskriminimit apo rezultatin përfundimtar të trajtimit të këtyre rasteve.

AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) ka njoftuar se gjatë vitit 2025 ka pranuar dy kërkesa për ofrimin e ndihmës juridike falas, që ndërlidhen me pretendime për diskriminim. Sipas agjencisë, këto raste janë evidentuar dhe trajtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe me legjislacionin tjetër përkatës.

Të dyja kërkesat janë aprovuar, pasi aplikuesit kanë përmbushur kriteret për të përfituar ndihmë juridike falas sipas nenit 10/A të Ligjit nr. 08/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas. Agjencia ka njoftuar se në këto raste ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar qasje efektive në drejtësi për përfituesit e ndihmës juridike falas.

KONKLUZION

Nga të dhënat e siguruara nga institucionet publike, rezulton se niveli i zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi (LMD) nga ana e autoriteteve publike është tejet i ulët. Megjithatë, emërimin e zyrtarëve përgjegjës për mbrojtje nga diskriminimi dhe themelimin e mekanizmave institucionale për promovimin e barazisë, zbatimi i obligimeve nga LMD-ja në shumë institucione mbetet kryesisht formal për shkak të mungesës së detyrave të qarta, kapaciteteve të kufizuara dhe faktit se këto përgjegjësi shpesh u ngarkohen zyrtarëve si detyra shtesë. Po ashtu, një numër i konsiderueshëm institucioneesh nuk kanë ofruar përgjigje ndaj kërkesave të Avokatit të Popullit ose nuk kanë ofruar të dhëna të plota lidhur me rastet e diskriminimit.

Zyra për Qeverisje të Mirë nxjerr në pah mungesën e një sistemi të unifikuar për evidentimin, monitorimin dhe raportimin e rasteve të diskriminimit. Shumë institucione nuk mbajnë statistika të detajuara sipas bazave të diskriminimit dhe nuk ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar efektivitetin e mekanizmave ekzistues. Kjo situatë kufizon mundësinë për të krijuar një pasqyrë të saktë të situatës së diskriminimit në vend dhe tregon nevojën për forcimin e koordinimit institucional, rritjen e llogaridhënies dhe funksionalizimin efektiv të mekanizmave për mbrojtjen nga diskriminimi në të gjitha nivelet e administratës publike.

Në përgjithësi, nga të dhënat që kemi pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (tek i cili shihet një përparim për dallim nga dy vitet paraprake kur nuk ka pasur fare të dhëna për rastet e diskriminimit që trajtohen në gjykata), Këshilli Prokurorial i Kosovës, Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, si dhe institucionet e pavarura dhe mekanizmat e tjerë mbikëqyrës, rezulton se rastet që ndërlidhen me diskriminimin dhe veprat penale me elemente diskriminuese janë të kufizuara. Në sistemin prokurorial dhe gjyqësor evidentohet një numër rastesh në trajtim, por me mungesë të theksuar të vendimeve përfundimtare në disa kategori dhe pa të dhëna të plota për bazat e diskriminimit.

Nga ana tjetër, institucionet e pavarura dhe mekanizmat administrativë thuhet se kanë trajtuar raste me elemente diskriminimi, por me mungesë të statistikave të detajuara dhe të standardizuara për

bazat e diskriminimit, epilogun e rasteve dhe kategorizimin e tyre. Këto gjetje tregojnë nevojën për forcimin e sistemit të evidentimit dhe raportimit të rasteve të diskriminimit, rritjen e transparencës institucionale dhe harmonizimin e qasjes ndërmjet institucioneve, me qëllim të krijimit të një pasqyre më të saktë dhe më të plotë për rastet e diskriminimit në praktikë.

Për sa i përket rekomandimit të Avokatit të Popullit që institucionet publike t'i publikojnë në mënyrë të qartë procedurat për paraqitjen e ankesave te Avokati i Popullit, në mungesë të përgjigjeve, Avokati i Popullit, pas kontrollimit të faqeve zyrtare të ministrive dhe komunave, ka gjetur se nga 19 ministri vetëm Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Mbrojtjes kanë publikuar linkun për procedurat dhe për paraqitjen e ankesave te Avokati i Popullit. Megjithëse, te disa ministri, për shkak të rikonstruimit të faqeve të tyre zyrtare, nuk ka qenë e mundur të konstatohet nëse ekziston linku për raportimin e diskriminimit te Avokati i Popullit. Ndërsa nga 38 komuna, vetëm Komuna e Istogut dhe Komuna e Graçanicës e kanë të vendosur linkun për ankesat te Avokati i Popullit, ndërsa Komuna e Fushë Kosovës dhe Komuna e Kamenicës e kanë linkun për të raportuar diskriminimin, i cili lidhet me Platformën e Zyrës për Qeverisje të Mirë të Zyrës së Kryeministrit lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Në fund, mbetet veçanërisht shqetësues mosveprimi dhe mungesa e përgjegjësisë në raport me kërkesat e Avokatit të Popullit, të Inspektoratit të Punës, Inspektoratit të Tregut, Inspektoratit të Arsimit dhe Inspektoratit Shëndetësor, duke qenë se këto institucione janë kompetente për trajtimin e ankesave në rastet kur Avokati i Popullit nuk ka kompetenca të plota për ndërhyrje.

VI. REKOMANDIMET

Për sa u përket gjetjeve lidhur me rastet e diskriminimit të hetuara nga Avokati i Popullit, rekomandimet përkatëse u janë adresuar autoriteteve përgjegjëse përmes raporteve individuale të rasteve. Këto raporte dhe rekomandimet e tyre mund të gjenden përmes lidhjeve të përfshira në këtë raport.

Lidhur me rekomandimet për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke pasur parasysh se rekomandimet e dhëna në raportet vjetore për vitet 2023 dhe 2024 nuk janë zbatuar në masën e kërkuar, Avokati i Popullit i rithekson ato edhe në këtë raport, si në vijim:

- Të gjitha institucionet që kanë detyrime specifike sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të hartojnë plane veprimi për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të paraqitura në raportet vjetore drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- Gjatë procesit të ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përcaktohen qartë mekanizmat e zbatimit të ligjit, kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse, duke dalluar mekanizmat për promovim dhe vetëdijesim nga mekanizmat mbrojtës dhe ankues, përfshirë ata administrativë dhe gjyqësorë.
- Të gjitha autoritetet publike, në nivel qendror dhe lokal, t'i funksionalizojnë njësitë për mbrojtje nga diskriminimi ose t'i emërojnë pa vonesë zyrtarët përgjegjës për mbrojtjen nga diskriminimi, t'i standardizojnë përshkrimet e detyrave të tyre dhe të mbajnë evidencë të rregullt për rastet që lidhen me pretendimet për diskriminim.

- Të organizohen trajnime të vazhdueshme për personelin e njësive dhe zyrtarët përgjegjës për mbrojtjen nga diskriminimi, lidhur me kuptimin dhe zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe me rolin mbikëqyrës të Avokatit të Popullit.
- Gjykatat dhe prokuroritë themelore të mbajnë të dhëna dhe regjistra të veçantë për rastet e diskriminimit, duke i integruar ato në Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe ta përshtatin sistemin e klasifikimit të rasteve në mënyrë që rastet e diskriminimit të identifikohen dhe raportohen veçmas nga rastet e tjera.
- Institucionet publike të sigurojnë publikimin e qartë në faqet e tyre zyrtare të procedurave për paraqitjen e ankesave pranë Avokatit të Popullit dhe të ndërmarrin aktivitete të rregullta promovuese dhe vetëdijësuese për publikun në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi.